



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike

URDHER

Nr. 134 Date 09.05.2003

PER
ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SH.A. "PORTI DETAR" VLORE
ME PERFHIRJEN E REZERVAVE

Drejtuar: Sh.a. "Portit Detar" Vlore

Ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe nenet 128, 150, te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem ,

URDHEROJ:

Ne aktet e themelimit te Sh.A. "Porti Detar" Vlore te behen ndryshimet e meposhteme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet, **me perfshirjen e rezervave, per vleren 142.491.000 leke**, e barabarte me 142.491 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A. "Porti Detar" Vlore, te behet 1.316.331.000 leke i barabarte me 1.316.331 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion. Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare". Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

Arben MALAJ

MINISTER



EKA
SANIE TAFI
RR. "PERLAT REXHEPI"
PALL "UNIKON" AP. NR1
TIRANE

RAPORT I SHKURTER PER SHITESE KAPITALI SH.A PORTI VLORE

Te nderuare zoterinje;

Ne marim persiper misionin e shiteses se kapitalit duke u mbeshtetur ne standartet kombetare dhe nderkombetare dhe njohurive e Normave profesionale qe kemi ne dispozicion

Per te realizuar kete objekt te misionit ne kerkuam dhe na u vu ne dispozicion dokumentat e meposhteme

-
1 Shkresen e ministries nr 2565 dt 3-04 -2003 me object zmadhimin e kapitalit te shoqerise :

2-Bilancin e shoqerise per periudhen deri ne 31-12 -2002 duke bere edhe sistemimin e rezultatit te vitit 2002 ne baze te shkreses se derguar nga Ministria e ekonomis dhe privatizimit.

3-Kemi ne dispozicion vendimin e pronarit te vetem te shtetit per shtimin e kapitalit

Burimet e fondeve qe shtojne kapitalin jane diferenca e rivlersimit nga krijimi per shumen leke 39.866.966. dhe te gjitha fondet etjera vijne si rezultat i ndarjes se fitimit me destinacion investime .

Deri ne dt 31-12 -2002 me shumen 66.200.186 jane shtuar aktivet e qendrushme si me poshte ;

1- Ndertesa shuma prej 53724751-leke

2-Makineri e pajisje shuma prej 2422154 leke

3-Mjete transporti shuma prej-8554060 leke



4- Inventare ekonomik shuma prej 1499497 leke

Shuma e likujditeteve ne banke per dt 31-12-2002 eshte e barabarte me shumen

92.318.745 leke kjo gje verteton se shtesa e kapitalit eshte plotesisht e mundur

Kapitali i neshkruar ka qene ne shumen 1.173.840.000 leke

Mbas shtimit te kapitalit eshte bere ne shumen 1.316.331.000 leke

Ne kemi verifikuat te gjitha postet e bilancit para dhe mbas shtimit te kapitalit dhe mbas verifikimit vertetojme se kapitali i nenshkruar mbasi eshte bere kjo shtese eshte e sakte

Totali i aktivitet dhe pasivitet nuk ndryshon

Bashkengjitur me Raportin ne kemi edhe bilancin para ndryshimit dhe mbas ndryshimit te kapitalit

Eksperti kontabel i autorizuar

Sanie Tafa

Tirane *Ekspert Kontabël e Autorizuar*

Me -----
SANIE TAF
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike

URDHER

Nr. 184 Date 9-6-2004

PER

NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A. "PORTI DETAR "

VLORE


Drejtuar : Sh.A. "Porti Detar" Vlore

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe neni 128, 150 te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare, me cilesine e aksionerit te vetem ,

URDHEROJ:

1. Kapitali Themeltar te zvogelohet per vleren 15 636 431 leke, e barabarte me 15 636,431 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A. "Porti Detar" Vlore, te behet nga **1 316 331 000 leke ne 1 300 694 569 leke** i barabarte me 1 300 694,569 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.



**AKT EKSPERTIMI I EKSPERTIT KONTABEL
MBI PAKSIMIN E KAPITALIT TE NENSHKRUAR
TE SHOQERISE "PORTI DETAR VLORE " Sh.A.**

Te nderuar zoterinj!

Marr persiper misionin e paksimit te kapitalit per disa asete te paksuara nga shoqeria
SHA PORTI VLORE

Misioni eshte kryer duke u bazuar ne :

-Urdherin e ministrit nr 282 dt 31-05-2000 me objekt zvogelim kapitali per hauzin e
peshkimit dhe te strukturave te tij .

-Ne standartet kombetare dhe nderkombetare si dhe ne Normat dhe kriteret e profesionit
tone.

Ne ligjin nr. 7638 te dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", Ligji nr.7661 date
19.01.1993 "Mbi kontabilitetin", Plani Unik Kontabel dhe me besimin qe me ka
dhene ministri i ekonomise i cili eshte edhe pronari i vetem ME 100% te
aksioneve dhe qe perfaqeson shtetin.

Hapi i pare per realizimin e kesaj procedure eshte njohja me gjithe legjislacionin perkates
dhe fillimi i proçedures nga ana e shoqerise.

Hapi i dyte, sigurimi i mandatit te Ekspertit te emeruar nga Ministri i ekonomise

Hapi i trete eshte sigurimi i bilancit te audituar deri ne dt 31-12-2003 dt e fundit ne te
cilen eshte vertetuar kapitali i shoqerise .

Pregatitja e raportit per certifikim dhe paraqitja e raportit per aprovim ne ministri .

Ne momentin e themelimit te kesaj shoqerie Kapitali i Nenshkruar ka qene
1.173.840.000leke. mbas themelimit ne vitin 2003 kapitali shoqerise ka shkuar
1.316.331.000 leke Ky kapitale eshte i vertetuar me aprovimin e deklaratave financiare
te fundit te vitit dhe une e quaj te vertet dhe te singerte .

Mbas kesaj date nuk eshte bere ndryshim kapitali

Qe nga fillimi i veprimtarise ekonomike si Sh.A shoqeria ka ne pronesin e saj active te
qendrushme te trupezura dhe te patrupezuara .

Duke operuar ne perputhje me objektin e misionit per paksimin e kapitalit per hauzin e
peshkimit kam konstatuar se ne kete hauz perfshihen

1-Objekti Frigorifer peshku nuk ka vlere

2-Objekti i perpunimit te rretave vlere e mbetur eshte ne shumen 4.559.139 leke

3-Oficina per materialet te anijeve te peshkimit 3.691.532

Znj. SANIE Tafa-Eksperte Kontabel e Autorizuar
Licenza n.034

4-Vlera e tokes siperfaqe 10.258 meter katrore me vlere 7.385.760 leke

5-Bashkia i ka dhene vertetim zyrtare shoqerise per cmimin e tokes per meter katror dhe gent –planin per ate

Shuma gjithsej e vleres se objekteve qe paksojne kapitalin jane 15.636.431 leke

Keto aktive kane qene te rregjistruara ne bilancet financiare te shoqerise deri ne dt 31-12-2003

Me 31.12.2003 kapitali i nenshkruar eshte i barabarte me 1.316.331.000 leke. sot ne dt 10-06-2004 kapitali i nenshkruar shkon ne shumen 1.300.694.569 leke

Sipas normatives se te Drejtes Shqiptare, qe paraqitet ne vijim, dhe ne veçanti asaj mbi Shoqerite Tregtare, mbi Kontabilitetin, Planin Unik Kontabel dhe ne te njejten linje me Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit, me veprimet e permendura me siper vetem gjykata vendos per paksiimin e kapitalit te nenshkruar duke u bazuar ne certifikimin e ekspertit kontabel te autorizuar .

Per ekzekutimin e mandatit te marre nga pronari me cilesin e aksionerit te vetem ne lidhje me paksimin e Kapitalit te Nenshkruar jam mbeshtetur ne dokumentet e meposhtme:

-Situaten kontabile me 31.12.2003, ne veçanti Aktiveve te qendrushme dhe kapitalit te nenshkruar ne kete date;

-Ne dokumentet ligjore te shoqerise

-Ne urdhrin e ministrit nr 282 te dt 31-05-2000 per paksimin Kapitalit te shoqerise:

-Ne shumen e vlerave te objekteve nga inventari dhe kontabiliteti i mbajtur nga shoqeria

-Ligji nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare";

-Ligji nr. 7661 date 19.01.1993 "Per Kontabilitetin";

-Plani Unik Kontabel, viti 1993.

-Inventarin Fizik te objekteve qe perfshin Hauzi i peshkimit

Ne mendojme qe te kaloje ne paksim kapitali shuma prej 15.636.431 leke shume e cila i ploteson te gjitha kerkesat ligjore per te paksuar kapitalin e nenshkruar me 100% aksione shteterore

Pas ketij paksimi

Aktivitet e qendrushme ne vlere kontabel neto shkojne nga shuma leke 1.198.114.730 leke. ne shumen 1.182.478.299 leke

Si perfundim une vlersoje se kapitali i nenshkruar i shoqerise SHA Port Detare Vlore shkon nga shuma 1316331000 leke ne shumen 1.300.694.569 leke

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

SANIE Tafa NR LIC 034

Tirane me dt 10-06-2004 Ekspert Kontabel Autorizuar

SANIE F. Tafa

TIRANE



"PORTI DETAR" SH.A. VLORE
 PROT 02
 DATE 25/12/2008

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
 DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 1031/Date 26.12.2008

PER

SISTEMIMIN E KAPITALIT TE SH.A "PORTI DETAR" VLORE

Drejtuar: SH.A "PORTI DETAR" VLORE

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem te Sh.a "Porti Detar" Vlore,

URDHEROJ:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet per vleren 63 740 431 leke , i barabarte me 63 740 aksione me vlere nominale 1000 leke secila
2. Kapitali Themeltar i shoqerise behet 1 364 435 000 leke, i barabarte me 1 364 435 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
3. Keto ndryshime te behen ne aktet e themelimit te shoqerise.
4. Bazuar ne Ligjin 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqerise "Porti Detar" Sarande per kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet perkatese ne rregjister.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.



Adresa: Blvd. "Deshmoret e Kombit" Nr.2
 E-mail: kabineti@mete.gov.al
 Internet: <http://www.mete.gov.al>

Tel: +355 4 226241
 Tel: +355 4 223158
 Fax: +355 4 234052

H. Bevdeti



REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
 DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE
 DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

Nr. 4280/...Prot.

Tirane, me 19/12 2008

Lenda: Miratojme bilancin kontabel dhe shperndarjen e rezultatit te vitit 2007.

SH.A "PORTI DETAR"

VLORE

Ne zbatim te Ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare", Neni 130,214, miratojme bilancin kontabel dhe shperndarjen e rezultatit te shoqerise per vitin 2007.

Fitimi i ushtrimit	2007	63 063 132 leke
Rezerve ligjore 5%		3 153 157 leke
Rezerve zhvillimi 85%		53 603 662 leke
Divident 10%		6 306 313 leke
Ndare ne:		
10% Dega Tatim Taksa		630 631 leke
90% Buxheti Ministrise se Ekonomise		5 675 682 leke

Likuidimi i Dividentit ti konfirmohet zyrtarisht Drejtorise se Administrimit te Prones Publike prane Ministrise se Ekonomise, brenda muajit Qershor 2008. Ekspertja Kontabel e Autorizuar Zj.Anita Pulaj te pergatise raportin e zmadhimit te kapitalit per perfshirjen e rezervave ne kapital.

MINISTRI
 GENCERULI

**Eksperte Kontabel Te Autorizuar
Anita PULAJ**

RAPORT

**PER ZMADHIMIN E KAPITALIT
TE SHOQERISE "PORTI DETAR" SH.A.**

VLORE

Tirane me 28.07.2008

RAPORT PER ZMADHIMIN E KAPITALIT

**MINISTRISE SE EKONOMISE
TREGTISE DHE ENERGJITIKES**

**Aksionerit te vetem te
"PORTI DETAR" SH.A.**

Me cilesine e Ekspertit Kontabel te Autorizuar te caktuar me Urdhrin nr. 4280/1 date 09.06.2008, - te Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes Per Pergatitjen e raportit per: Zmadhimin e Kapitalit Themeltar te "PORTI DETAR" sh.a Vlore, kemi kryer misionin per pergatitjen e raportit te Zmadhimit te Kapitalit Themeltar me anen e perfshirjes se rezervave ne kapital.

Per kryerjen e angazhimit tim per zmadhimin e kapitalit me perfshirjen e rezervave ne kapital jam mbeshtetur ne:

Bazen ligjore :

- Ligji 9901, date 06.05.2008 "Per shoqerite tregtare", neni 168-179 per zmadhimin e kapitalit.

Dokumentacionin e shoqerise:

- Akt-themelimi, Statuti, Vendimi nr. 23540 date 20.12.2000 i ndryshuar i Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane .
- Urdhrin nr 4280/1 date 09.06.2008i Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes.
- Bilancin kontabel dhe pasqyrat financiare te vitit 2007 te miratuara nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, aksionere e vetme e "Portit Detar" sh.a Vlore.
- Raporti i Ekspertve Kontabel te Autorizuar per Bilancin kontabel dhe pasqyrat financiare te vitit 2007

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi ndryshimin e zerit 'kapitali themeltar' pjese perberese ne grupin "kapitalet e veta" mbi permbushjen e angazhimit per zmadhimin e kapitalit themeltar me perfshirjen e rezervave ne kapital.

Zmadhimi i kapitalit themeltar me perfshirjen e rezervave ka si burim fitimet e viteve te kaluara ne rezerva zhvillimi sipas vendimeve te miratimit te bilanceve, pasqyrave financiare dhe shperndarjen e rezultatit per secilin vit si me poshte:

Viti 2003	473.754	leke
Viti 2004	26.334.000	leke
Viti 2005	35.851.162	leke
Viti 2006	32.629.649	leke
Viti 2007	53.603.662	leke

Totali	148.892.227	leke
---------------	--------------------	-------------

Duke u mbeshtetur ne bilancin kontabel te vitit 2007 dhe ndryshimet e pesuara deri ne marrjen persiper te ketij misioni kapitali themeltar i shoqerise "PORTI DETAR" sh.a Vlore eshte **1.215.543.000** leke i barabarte me **1.215.543** aksione me vlere nominale 1000 leke secila.

Efekti i ndryshimeve te kapitalit themeltar me perfshirjen e rezervave ne kapitalin e nenshkruar eshte si me poshte:

- Kapitali i nenshkruar para ndryshimit **1.215.543.000 leke**
- Shtimi i kapitali te nenshkruar **148.892.000 leke**
- Kapitali i nenshkruar pas zmadhimit **1.364.435.000 leke**

Per efekt rumbullakosje shuma prej 227 leke kalon ne diferenca rivlersimi.

Kapitali I shoqerise "PORTI DETAR" sh.a Vlore eshte **1.364.435.000 leke** (njemiliardetreqindegjashtedhjetekater milion e katerqindetridhjetepesemije leke) i barabarte me **1.364.435** aksione me vlere nominale 1000 leke secila.

- Ky kapital zoterohet 100% nga aksioneri I vetem Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes .

Sipas opinionit tone misioni i zmadhimit te kapitalit eshte kryer ne perputhje me kuadrin ligjor dhe permbush te gjitha kerkesat ligjore per kete qellim.

Tirane me 28.07.2008


Rruga "Myslym Shyri"

Lagja nr.9

Cel.0692087743

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR

ANITA PULAJ





PRIT 279
DATE 13.08.2013

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OFRIMIT TE SHERBIMEVE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

URDHËR

Nr. 66 Datë 7.8.13

PER

ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A "PORTI DETAR" VLORE
Drejtuar: SH.A "PORTI DETAR", VLORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të paragrafit të parë të nenit 2 të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, datë 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, datë 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, datë 22.04.2002, Urdhër Nr.564 datë 13.06.2013 të METE-s dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionarit të vetëm të Sh.a "Porti Detar" Vlore,

URDHËROJ:

1. Kapitali Themeltar të zvogëlohet për vlerën 579 823 000 leke , i barabartë me 579 823 aksione me vlerë nominale 1000 leke secila.
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 784 612 000 lekë, i barabartë me 784 612 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë " Porti Detar" Vlore për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

FLORJON MIMA



kyena me origjinalin
Dh. 13.08.2013
[Signature]

[Signature]

RAPORT

I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE

Porti Detar SH.A.
Vlore

Vlore, me 4 Korrik 2013

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes, ne perfaqesine
e Aksionerit te Shoqerise "Porti Detar Vlore" SHA,
Drejtimit te Shoqerise "Porti Detar Vlore" SHA,

Zoterinj,

Ne permushje te misionit te mare, kemi audituar disa nga pasqyrat financiare
te Shoqerise "Porti Detar Vlore" SHA, dhe pikerisht pasqyren e ndryshimeve
ne kapital, dhe zera te vecante te Pasqyrave Financiare te drejtave dhe
detyrimeve (Aktiv-Pasiv), si dhe nje permbledhje te politikave kontabel te
rendesishme dhe informacione te tjera shpjeguese.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyren Financiare

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyreve
bazuar ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe te
Raportimit Financiar, ne pershtatshme per pergatitjen e nje pasqyre financiare
te tille dhe per ate nivel kontrolli te brendshme, qe drejtimi e konsideron te
nevojshme per te bere te mundur pergatitjen e pasqyres financiare pa anomali
materiale, si pasoje e mashtrimit apo gabimit.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi kete pasqyre financiare
bazuar ne auditimin tone. Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standartet
Nderkombetare te Auditimit. Keto Standarte kerkojne qe ne te respektojme
kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin per te arritur sigurine
e arsyeshme se pasqyra financiare nuk ka anomali materiale.

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave per te siguruar evidencen e
nevojshme te auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese te
dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura jane ne varesi te
grykimit te audituesit, perfshire ketu vleresimin e rrezeqeve te anomalise
materiale ne pasqyren financiare si pasoje e mashtrimit apo gabimit.

Ne vleresimin e ketyre rrezeqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e
brendshem te entitetit qe ka te beje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te
pasqyres financiare me qellim qe te percaktoj procedure auditimi qe jane te
pershtatshme per rrethanat, por jo per qellime te shprehjes se nje opinion mbi
efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Nje auditim perfshin gjithashtu, vleresimin e pershtatmerise se politikave
kontabel te perdorura, te arsyeshmerise se cmuarjeve kontabel te bera nga
drejtimi, si edhe vleresimin per paraqitjen e pergjithshme te pasqyres financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe
e pershtatshme per te sherbyer si baze per opinionin tone te auditimit.

Mbi kryerjen e angazhimit per zvogelimin e Kapitalit te Porti Detar Vlore

Ne cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar, kam pranuar misionin e besuar
prej Jush me Urdherin Nr 564, date 13.06.2013 si vijon:

**Pergatitjen e dokumentacionit per zvogelimin e kapitalit themelart te
SHA "Porti Detar Vlore", per vleren e Portit te Ri Zverec, me siperfaqe,
80.38 ha.**

Ne kryerjen e ketij misioni jam mbeshtetur ne bazen ligjore si vijon:

- Ligji Nr 9901, date 14.04.2008 Per Shoqerite Tregetare,
- Ligji Nr 8743, date 22.02.2001 Per pronat e Paluajtshme te Shtetit,
- Ne Raportin e Vleresimin te truallit nga EKR Violeta Haloci dhe dy
eksperte vleresues ne vitin 2010.
- Ne Pasqyrat Financiare te Shoqerise Porti Detar Vlore SHA dhe auditimin
ligjor te tij te vitit ushtrimor te mbyllur me 31.12.2012 si dhe pasqyres se
AAM me 31.12.2012.
- Ne dokumenta te tjera Ligjore te Shoqerise.

Informacion historik mbi pronesine dhe vleresimin e tokes.

- Shoqeria SHA "Porti Detar Vlore" ne momentin e transformimit si Shoqeri
Tregetare ka evidentuar pasurine e saj dhe me Urdherin e Ministrise te
Puneve Publike dhe Transportit Nr 60/1, date 19.02.1999 ka miratuar

ekspertin vleresues Aleksander Gjata per vleresimin e pasuresise se
Shoqerise ne funksion te ketij transformimi.
Sqarojme se toka-truall e vleresuar sa me siper dhe e evidentuar edhe me
Vertetimet e Bashkise te asaj kohe **eshte vleresuar me 720 leke/m2.**
- Ne vitin 2010, EKR Violeta Haloci dhe dy eksperte vleresues kane kryer
misionin e rivleresimit te tokes-truall **me 14.000 leke/m2.**
Ne po kete raport eshte saktuar siperfaqja e Truallit qe i takon Portit te
Ri me nje siperfaqe prej **805.309,375 m2 ose 80.54 ha.**
**Bazuar ne dokumentacionin e Shoqerise siperfaqja e Portit te Ri
eshte 80.54 ha dhe jo 80.38 ha e cilesuar ne urdherin e METE-s.**

Ne perfundim te ketij angazhimi ju informojme se:

Ne permushje te misionit te ngarkuar kemi shqyrtuar dokumentacionin
e sipercituar dhe kemi kryer verifikimet e nevojshme.
Referuar Pasqyrave Financiare te Shoqerise "Porti Detar Vlore" SHA me
31.12.2012 Struktura e Kapitalit te Shoqerise paraqitet si vijon:

Struktura e Kapitalit te Shoqerise "Porti Detar Vlore" SHA me 31.12.2012 para zvogelimit te kapitalit me vleren e truallit paraqitet si vijon:

- Kapitali Aksioner	1.364.435.000 leke
- Rezerva Rivleresimi	11.711.055.182 leke
- Rezerva staturore	1.536.420 leke
- Rezerva Ligjore	31.592.953 leke
- Fitim (Humbje) e mbartur	0 leke
- Fitim (Humbje) vitit 2012	(20.243.497) leke

Total Kapitali **13.088.376.058 leke**

Ne zbatim te Urdhrit te METE Nr 564, date 13.06.2013 behet
zvogelimi i Kapitalit te Shoqerise me:

- 1- Vleren e truallit prej 80,54 ha me nje vlere prej:

$$805.309,375 \text{ m}^2 \times 14.000 \text{ leke/m}^2 = 11.274.331.250 \text{ leke}$$

Per kete vleresim jemi referuar ne dy raporte per vleresimin e truallit
giate historikut te Shoqerise si dhe dokumenta te tjera ligjore.
Sqarojme se ne keto vleresime toka eshte rivlersuar nga 720 leke per m2
ne 14.000 leke per m2, per rrjedhoje vlera e zvogelimit te truallit prej
11.271.331.250 leke ka si kunderparti ne Grupin e kapitalive te veta dy
nenlogari te tij te cilat do te zvogelohen nga ky proces, ate te kapitalit te
regjistruar dhe rezervat e rivleresimit si me poshte vijon:

- Zvogelim ne kapitalin e regjistruar $805.309,375 \text{ m}^2 \times 720 \text{ leke/m}^2 =$
579.822.750 leke
- Zvogelim ne rezerva te rivleresimit $805.309,375 \text{ m}^2 \times 13.280 =$
10.694.508.500 leke

**Total vlera me te cilen zvogelohet grupi i Kapitaleve te veta te
Shoqerise eshte 11.274.331.250 leke.**

Shoqeria SHA "Porti Detar Vlore", mbas ketij zvogelimi, do te kete ne
pronesi te saj nje siperfaqe truallit prej:

- o Porti Vlore 53.025 m2 me vlere 742.350.000 leke
- o Porti Himare 3.250 m2 me vlere 45.500.000 leke
- o Total Truallit **787.850.000 leke**

Vlera e truallit ne Bilancin e 31.12.2012 eshte: 12.062.181.250 leke
Zvogelohet me vleren prej: 11.274.331.250 leke
Vlera e Truallit pas zvogelimit: 787.850.000 leke

- Shoqeria mbas miratimit te ketij Raporti nga METE duhet te kryeje
veprimet kontabel si vijon:

Kredi llog.kl. 2 Truallit per vleren **11.274.331.250 leke,**
Debi llog.kl. 1 Kapitali i regjistruar **579.823.000 leke dhe**
Debi llog.kl. 1 Rezerva te tjera **10.694.508.250 leke**

Ne perfundim te ketij misioni konkludojme :

**Kapitali i Regjistruar Shoqerise "Porti Detar Vlore SHA" zvogelohet
me nje vlere prej 579.822.750 leke.**

Zvogelimi i Kapitalit te Shoqerise do te behet per shumen 579.823.000
leke per efekt te plotepjestimit me 1000, e cila perfaqson vleren nominale
te nje aksioni dhe diferenca prej 250 leke do te kaloje ne zerin-rezerva te
tjera.

**Pas zvogelimit, Kapitali i Regjistruar i Shoqerise "Porti Detar
Vlore" SHA do te jete 784.612.000 leke, e cila perfaqson 784.612
aksione dhe vlera nominale e nje aksioni eshte 1000 leke.**

Sugjerime :

Pas zvogelimit te Kapitalit te Regjistruar me truallin e Portit te Ri, Shoqeria
ka zvogeluar ndjeshem Kapitalin e Regjistruar te saj dhe rekomandojme te
zmadhoje kete ze me rezervat e rivleresimit.

**Struktura e Kapitalit te Shoqerise "Porti Detar Vlore" SHA pas
zvogelimit te kapitalit me 31.12.2012.**

- Kapitali Aksioner	784.612.000 leke
- Rezerva Rivleresimi	1.016.546.932 leke
- Rezerva staturore	1.536.420 leke
- Rezerva Ligjore	31.592.953 leke
- Fitim (Humbje) e mbartur	0 leke
- Fitim (Humbje) vitit 2012	(20.243.497) leke

Total Kapitali **1.814.044.808 leke**

Opinionit i audituesit

**Sipas opinionit tone misioni i zvogelimit te kapitalit
eshte kryer ne perputhje me kuadrin ligjor dhe permushje
te gjitha kerkesat ligjore per kete qellim.**

Eksperte Kontabel e Regjistruar **Tirane me 04.07.2013**

Ludmilla Paluka

Rr.Hajdar Hidi, Nd 2 Zyra 9
Nr.contacti 069 20 36 339.

LUDMILLA MONE PALUKA
E.K.A. LICENS NR 161
G.FISK. K716160385



03

462/2
10.10.2014



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPIERMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

URDHËR

Nr. 442 Datë 8.10.2014

PER

ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SH.A "PORTI DETAR" VLORE

Drejtuar: SH.A "PORTI DETAR" VLORE ✓

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të paragrafit të parë të nenit 2 të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, datë 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, datë 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, datë 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionarit të vetëm të Sh.a "Porti Detar" Vlorë.

URDHËROJ:

1. Kapitali Themeltar i zvogëlohet për vlerën 53 273 000 leke, i barabartë me 53 273 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila, që i përket sistemit të rezervave të krijuara nga fitimi dhe humbjeve të mbartura.
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 731 339 000 lekë, i barabartë me 731 339 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Porti Detar" Vlorë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

*Verifikohet
njëra me origjinalin*

[Signature]

MINISTRI
[Signature]
ARBEN AHMETAJ

PERMBAJTJA

- *Raporti i ekspertës kontabel te regjistruar*
- *Shkresa e MZHETS*
- *Ekstrakti i QKr-se*
- *Pasqyrat financiare te vitit 2013*

**RAPORT PER SISTEMIMIN E KAPITALIT TE REGJISTRUAR
TE SHOQERISE
« PORTI DETAR VLORE » SHA**

Drejtuar: Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Siper marrjes

Shoqerise « Porti Detar Vlore » sha

Me cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar, te caktuar me Shkresen Nr. 4858/1 date 30/07/2014 te Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Siper marrjes, per sistemimin e kapitalit duke mbuluar humbjen e mbartur dhe humbjen e vitit 2013, kemi audituar pasqyrat bashkelidhur te levizjes se kapitaleve te veta te shoqerise "Porti Detar Vlore" sha per vitet 2012 dhe 2013. Keto pasqyra jane pergjegjesi e drejtimit te shoqerise "Porti Detar Vlore" sha.

Baza ligjore per realizimin e ketij misioni eshte:

- Ligji Nr. 7850, date 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar
- Ligji Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- Ligji Nr. 9228, date 29/04/2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finaciare".
- Ligji Nr. 10091, date 05/03/2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar"
- Ligji Nr. 9723, date 05/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
- Shkresa Nr 4858/1 prot., date 30/07/2014 te Aksionerit te Vetem, Ministrit te Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Siper marrjes

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi pasqyrat financiare te siperpermendura, bazuar ne auditimin tone, te cilat jane baze per sistemimin e kapitalit te regjistruar te kesaj shoqerie. Ne kryem auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditimin per te zoteruar siguri te arsyeshme se keto pasqyra nuk permbajne anomali materiale. Auditimi perfshin shqyrtimin, mbi baze te testeve, te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet e dhena ne pasqyrat financiare. Auditimi perfshin gjithashtu vlersimin e parimeve te kontabilitetit te ndjekura dhe vlersimet e rendesishme te bera nga drejtimi, si dhe vlersimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave.

Shoqeria "Porti Detar Vlore" sha eshte themeluar me 23/03/1999 si Shoqeri Anonime me kapital te regjistruar aktual ne shumen 784 612 000 leke, me aktivitet "Kordinimi i aktiviteteteve tregetare brenda territorit te portit, ndertim, menaxhim, ruajtje objektesh brenda portit, shkarkim mallrash per llogari te subjekteve juridike dhe shteterore"

Per sistemimin e ketij kapitali ne jemi referuar pasqyrave financiare te vitit 2012 dhe 2013 te cilat jane te miratuara nga aksioneri i saj.

Grupi i kapitaleve te veta gjendje ne 31/12/2013 eshte i perbere si me poshte:

• Kapitali i regjistruar	784 612 000 leke
• Rezerva statutore	1 536 420 leke
• Rezerva ligjore	31 592 953 leke
• Rezerva te tjera	1 016 546 932 leke
• Humbja e vitit 2012	(20 243 497) leke
• Humbja e vitit 2013	(34 566 111) leke
• Totali i kapitalele te veta	1 779 478 697 leke

Ne vitin 2012 rezultati i shoqerise eshte me humbje ne shumen 20 243 497 leke, te cilat keto pasqyra jane te miratura nga aksioneri me destinacion, qe humbja te mbartet ne vitin pasardhes.

Po keshtu edhe rezultati i vitit 2013 eshte me humbje ne shumen 34 566 111 leke, pasqyra te miratuara me shkresen nr.4858/1 date 30/07/2014, ku aksioneri i shoqerise ka vendosur mbulimin e humbjeve duke sistemimuar kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Ne zbatim te shkreses nr.4858/1 date 30/07/2014 kapitali i regjistruar sistemohet si me poshte :

• Zvogelohet per humbjen e vitit 2012 ne shumen.....	(20 243 497) leke
• Zvogelohet per humbjen e vitit 2013 ne shumen.....	(34 566 111) leke
• Zmadhohet per rezervat statutore ne shumen	1 536 420 leke
• Totali i sistemimit per difference.....	(53 273 188) leke

Per efekt te rumbullakosjes se shifres se kapitalit, kapitali i regjistruar zvogelohet per 53 273 000 leke, per shumen 188 leke zvogelohet zeri rezerva te tjera.

Nga ndryshimi i kapitalit efektet ne kontabilitet jane :

• Paksim te kapitalit per	(53 273 000) leke
• Paksim te zerit rezerva statutore	(1 536 420) leke
• Paksim te zerit rezerva te tjera	(188) leke
• Mbylljen e humbjes se vitit 2012	20 243 497 leke
• Mbylljen e humbjes se vitit 2013	34 566 111 leke

Ne shkresen nr. 4858/1 date 30/07/2014 eshte perfshire dhe zeri rezerva te tjera ne shumen 1 016 546 932 leke per sistemimin e kapitalit.

Nga verifikimi i dokumentacionit prane shoqerise na rezultoi se ne Zerin " Rezerva te tjera " eshte pasqyruar teprica e rivlersimit te asetëve, teprice kjo e ardhur nga rivlersimi i truallit per 805 309.375 m2 i bere ne vitin 2010 ne shumen 11 441 840 500 leke.

Teprica e rivlersimit eshte pakësuar ne vitin 2013 ne shumen 10 694 508 500 leke, nga zvogelimi i siperfaqes se truallit (porti i ri) per 805 309 m2 dhe kalimi i kesaj siperfaqe ne pronesi te Bashkise se Qytetit Vlore.

Ne zbatim te Ligji Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligji Nr. 9228, date 29/04/2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finaciare" dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit qe shoqeria aplikon, ne sistemimin e kapitalit nuk eshte perfshire rezerva e rivlersimit te AQT-ve per shumen 1 016 546 932 leke (pasqyruar ne bilanc si rezerva te tjera), e cila duhet te ndryshoje me ndryshimin qe mund ti ndodh vleres se siperfaqes se truallit qe i perket, meqenese trulli eshte aset qe nuk amortizohet dhe nuk mund te kalohet edo vit ne fitimet e mbartura ne shumen sa eshte amortizimi i vleres se shtuar te asetëve .

Kapitali i regjistruar i "Porti Detar Vlore" sha, para ketij misioni eshte 784 612 000 leke, me 784 612 aksione me vlere nominale 1.000 leke secila.

Kapitali i regjistruar i shoqerise zvogelohet per 53 273 000 leke (+1 536 420 – 20 243 497-34 566 111). Efekti i ndryshimeve te kapitalit te regjistruar eshte si me poshte:

- Kapitali i regjistruar para ndryshimit 784 612 000 leke
- Kapitali i regjistruar Zvogelohet 53 273 000 leke
- Kapitali i regjistruar pas Zvogelimit 731 339 000 leke

Kapitali i regjistruar i shoqerise "Porti Detar Vlore" sha, pas zvogelimit eshte 731 339 000 leke (shtateqind e tridhjetenji milion e treqind e tridhjet e nentemije leke)

Ky kapital zoterohet 100% nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarrrjes.

Ne perfundim te misionit qe na eshte caktuar, duke kryer te gjitha ekzaminimet e nevojshme, pasi verifikuam te gjitha procedurat per zvogelimin e kapitalit raportojme se e kemi plotesuar kete detyre sipas kerkesave ligjore ne fuqi.

Sipas opinionit tone jane zbatuar te gjitha kerkesat e Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" per ndryshimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise.


Ky raport mbahet ne 4 (kater) kopje te njejta.

EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR
ANITA PULAJ

Tirane me 20/09/2014

Raport per sistemimin e kapitalit te shoqerise "Porti Detar Vlore" sha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
 DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHITETËRORE

Nr. 23557/1 Prot.

Tiranë, më 23/12 2020

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 314 Datë 23/12/20

PËR

ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "PORTI DETAR" SHA VLORË

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme Nr. 149, datë 16.11.2020 "Për miratimin e Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr.16, datë 13.11.2020 "Mbi marrjen në dorëzim të situatës faktike të objektit "Projekt zbatimi dhe punime për rehabilitimin e Portit të Vlorës" dhe përgatitjen e dokumentacionit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Porti Detar" sha Vlorë, për vlerën faktike të investimit të kryer", me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Porti Detar" sha Vlorë;

VENDOSA:


1. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 2,124,266,000 lekë, i barabartë me 2,124,266 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë pas zmadhimit bëhet 2,855,605,000 lekë, i barabartë me 2,855,605 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Porti Detar" sha Vlorë, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjister.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri;

Web: www.financa.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
 DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHITETËRORE

Nr. 21124/3 Prot.

Tiranë, më 16/11 /2020

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 149 Datë 16/11/20

PËR

MIRATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 16, DATË 13.11.2020 "Mbi marrjen në dorëzim të situatës faktike të objektit "PROJEKT ZBATIMI DHE PUNIME PËR REHABILITIMIN E PORTIT TË VLORËS" DHE PËRGATITJEN E DOKUMENTACIONIT TË ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË "PORTI DETAR" SH.A VLORË, PËR VLERËN FAKTIKE TË INVESTIMIT TË KRYER.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të "Portit Detar" sha Vlorë;

VENDOSA:

1. Miratimin e Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 16, datë 13.11.2020 "Mbi miratimin e marrjes në dorëzim të situatës faktike të objektit "Projekt zbatimi dhe punime për rehabilitimin e Portit të Vlorës".
2. Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Porti Detar" sh.a Vlorë, për investimin e kryer bazuar në dokumentacionin justifikues.
3. Audituesi Ligjor Znj. Anila Pulaj, të përgatisë raportin përkatës në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi. Bashkëlidhur raportit të jetë dokumentacioni i plotë që vërteton investimin e kryer.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi shoqëria "Porti Detar" sh.a Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri;

Web: www.financa.gov.al



Nr. 143 Prot.

Tiranë, më 3.9.2021

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 78 Datë 3.9.2021

PËR

ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "PORTI DETAR" SHA VLORË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, VKM-së Nr.1023, datë 16.12.2020 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të MIE-s të pronës shtetërore në zonën kadastrale Nr.8603", VKM-së Nr. 245, datë 22.4.2021 "Për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, për njësinë administrative Vlorë të disa pasurive me vendndodhje në zonën kadastrale 8602 dhe për disa ndryshime në VKM-në Nr. 586, datë 10.9.2004 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror" të ndryshuar, VKM-së Nr. 465, datë 30.7.2021 "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga "Porti Detar" Vlorë te MFE dhe transferimin në Fondin e Pasurive të Paluajtshme, për mbështetjen e investimeve strategjike, të pronave të paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8602, Bashkia Vlorë, vënien e tyre në dispozicion për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Marina di Valona", me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Porti Detar" sha Vlorë;

VENDOSA:

1. Kapitali themeltar të zvogëlohet për vlerën 2,673,959,000 lekë, i barabartë me 2,673,959 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë pas zvogëlimit bëhet 181,646,000 lekë, i barabartë me 181,646 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Porti Detar" sha Vlorë, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



"PORTI DETAR" SH.A. VLORE
PROJ. 335/2
DATE 11.08.2021

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

**PËR VLERËSIMIN E SISTEMIMIT TË KAPITALIT TË REGJISTRUAR
TË SHOQËRISË
"PORTI DETAR" SHA, VLORE**

VLORE

Tirane me 09/08/2021

Shkrese percjellese

Drejtuar: "Porti Detar" sha, Vlore

Vlore

Lenda: Dergimi i Raporteve per Sistemimin e Kapitalit te Regjistruar te Shoqerise "Porti Detar" sha, Vlore

Ne zbatim te Nr. 1 datë 20/01/2021, si dhe me vendimin nr. 33 datë 28/05/2021 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë "Per kryerjen e procedurave te sistemimit te kapitalit te shoqerise "Porti Detar" sha, Vlore, bashkangjitur ju dergojme:

Dy kopje origjinale te Raportit te Audituesit Ligjor, Anita Pulaj, per sistemimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise "Porti Detar" sha, Vlore , te hartuar me date 05/08/2020

1. Kopje ID dhe Kopje License te Audituesit Ligjor

Pas miratimit nga Financave dhe Ekonomisë shoqeria "Porti Detar" sha, Vlore duhet te vazhdoje proceduren ligjore te depozitimit te tij prane Regjistrimit Tregtar. (Afati i depozitimit prane QKB-se eshte brenda 30 diteve kalendarike nga data e miratimit te raportit nga Financave dhe Ekonomisë)



BLV. Gjergj Fishta, Pall G& P, hyrja II, Kati II, mbi Credins Bank, Tirane,
Nr. Kontakti Cel.0692087743 , e-mail pulaj_anita@yahoo.com

PËRMBAJTJA

- *Raporti i Audituesit Ligjor për Sistemimin e kapitalit*
- *Aneksi 1*
- *Aneksi 2*
- *Aneksi 3*
- *Urdhri i MFE për zvogëlimin e kapitalit*
- *Vendimi i Asamblesë për sistemimin e kapitalit*
- *Ekstrakti historik i shoqërisë « Porti Detar Vlorë » Sha,*
- *Pasqyrat financiare të vitit 2020*

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

**PËR VLERËSIMIN E SISTEMIMIT TË KAPITALIT TË REGJISTRUAR TË SHOQËRISË
“PORTI DETAR VLORË” SHA**

Drejtuar: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

“Porti Detar” Sha, Vlorë

Me cilësinë e Audituesit Ligjor, të caktuar me vendimin Nr. 1 datë 20/01/2021, si dhe me vendimin nr. 33 datë 28/05/2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, kemi kryer procedurat e marrjes së sigurisë për sistemimin e kapitalit të shoqërisë “Porti Detar Vlorë” sha për :

